

20180110120

L I G J
PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR KOMUNIKIME ELEKTRONIKE

Neni 1

Në Ligjin për komunikime elektronike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 39/14, 188/14, 44/15 dhe 193/15), në nenin 16 paragrafi (1) në alinenë 5 presja zëvendësohet me lidhëzën "dhe".

Në alinenë 6 presja zëvendësohet me pikë.

Alinetë 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14 shlyhen.

Neni 2

Në nenin 22 paragrafi (2) në alinenë 13, pikëpresja zëvendësohet me lidhëzën "dhe".

Alineja 14 shlyhet.

Neni 3

Dispozitat nga neni 22 paragrafi (2) alinetë 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13 të Ligjit për komunikime elektronike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 39/14, 188/14, 44/15 dhe 193/15), nuk do të zbatohen nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 1 shtator 2018.

Neni 4

Drejtori i cili është emëruar në periudhën nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në 1 shtator 2018, është i obliguar ta plotësojë kushtin për njohjen e gjuhës së huaj më së voni në afat prej një viti nga dita e zgjedhjes së tij.

Drejtorit i cili nuk do ta plotësojë kushtin për njohjen e gjuhës së huaj në afatin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni i ndërpritet mandati.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".